



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 4 paragrafi 1.2 dhe nenin 15 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës / E-mailit njoftues të Stacionit të Policisë në Podujevë të datës 26.03.2024, si dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa nga mbledhja e datës 28.03.2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim bëhet plotësim ndryshimi i përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB në Komunën e Podujevës, përkatësisht zëvendësimi i një anëtari, dhe atë:

- **z.Bashkim Bajrami**, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, sipas detyrës zyrtare caktohet anëtar në kuadër të KKSB, në vend të **z.Nijazi Jashari** i cili është pensionuar.

2. Zëvendësimi i të përmendurit, bëhet konform Udhëzimit Administrativ në fuqi, dhe atë sipas aktit / njoftimit përkatës të paraqitur nga Stacioni i Policisë në Podujevë.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nr.prot.01-016/01-0030693/22 i datës 29 prill 2022, me plotësim ndryshimet përkatëse.

Neni 3

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 dit pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0020881/24,
Podujevë, datë: 29 mars 2024

